

**STATUTI**  
I  
**SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LOG IN TAXI” SH.P.K**

Sot më datë 03 Prill 2023, duke u bazuar në Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" i ndryshuar, si dhe në Ligjin Nr.9723, datë 03.05.2007 "Për Qëndrën Kombëtare të Rregjistrimit" i ndryshuar, ne të nënshkruarit shprehim vullnetin tonë të lirë dhe të plotë, për të nënshkruar këtë statut me qëllim krijimin e shoqërisë "LOG IN TAXI" sh.p.k.- si më poshtë vijon:

**KREU I**  
**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja, Selia**

**NENI 1**

**Data e Themelimit, Emri dhe Themeluesit**

1.1 Sot, në datë 03 Prill 2023, ne, themeluesit, kemi krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "**LOG IN TAXI**" SH.P.K

1.2 Themeluesit e shoqërisë janë :

I. **MARSEL MESITI** i datëlindjes 16/09/1990, i biri i XHELIL-it, lindur në Gramsh dhe banues në Rrugë "Besim Alla" Njesia Bashkiake Nr.14, Tirane, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal J00916018D.

I cili kane vendosur krijimin e shoqërisë dhe miratimin e statutit të shoqërisë në bazë të legjislacionit në fuqi të Republikës së Shqipërisë veçanërisht sipas Ligjit 9901 dt 14.04.2008, "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare" i ndryshuar dhe si person juridik të zhvillojnë aktivitetin në përputhje me legjislacionin Shqiptar në fuqi dhe me normat e këtij statuti. Ky statut hyn në fuqi pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

**NENI 2**

**Objekti**

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

Sherbim Taksi, transport kombetare dhe nderkombetare udhetare, Si dhe cdo aktivitet tjeter te lejuar nga Legjislacioni Shqiptar..

**NENI 3**  
**Kohëzgjatja**



- 3.1 Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar, duke filluar nga data e rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit, me përjashtim të rastit të mbarimit të saj sipas kushteve të parashikuara në ligj ose me vendim të ortakëve të shoqërisë.

#### NENI 4

##### Selia

- 4.1 Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: Njesia Bashkiake nr.14, Rruga Besim Alla , Ndertesa Nr.24, Hyrja Nr.2, Apartamenti Nr.12, Targa Automjeti AB 896 JH, Tirane.
- 4.2 Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon :  
e-mail: marsel\_mesiti@icloud.com  
Nr.Cel: 0695574017

#### KREU II

##### Neni 5

##### Kapitali themeltar

- 5.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (Një qind mijë) Lekë, tërësisht i shlyer nga ortaket përpara regjistrimit te shoqërisë. Pjesëmarrja e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:

1. Ortaket themelues: **MARSEL MESITI** Zotëruar i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 (Njëqind mijë) Lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

#### NENI 6

##### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

- 6.1 Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit të një eksperti te autorizuar dhe licensuar per keto kontribute me vendim asambleje të shoqërisë sipas kërkesës së administratorit.
- 6.2 Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
- 6.3 Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit, vendimet merren me 4/5e zotëruesve të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 6.4 Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

#### Neni 7

##### Transferimi i kapitalit

- 7.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:  
a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;

- b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - ç) dhurimit;
  - d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.
- 7.2 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, ndërsa për persona të tjera jashtë shoqërisë do të funksionojë e drejta e parablerjes, për sa nuk parashikohet ndryshe ne statut.
- 7.3 Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

### KREU III

#### ORGANET VENDIMMARRESE DHE DREJTUESE

##### Neni 8

###### Organji Vendimmarrar

- 8.1 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
- 8.2 Asambleja e Ortakeve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton cdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.
- 8.3 Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:
  - a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) ndryshimet e statutit;
  - c) emërimin e shkarkimin e administratorit/ëve;
  - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
  - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
  - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorit/ëve;
  - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- 8.4 Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- 8.5 Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- 8.6 Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

##### Neni 9

###### Mënyra e thirrjes se mbledhjes se Asamblese se Pergjithshme

- 9.1 Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.
- 9.2 Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 10

##### Kuromi

- 10.1 Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë 4/5 e zotëruesve të kuotave të kapitalit të shoqërisë.
- 10.2 Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse janë të pranishëm ortakët që zoterojnëtë paktën 4/5 e kuotave të kapitalit të shoqërisë, të cilët votojnëme shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
- 10.3 Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumi të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëtin rend dite.

#### Neni 11

##### Marrja e vendimeve

- 11.1 Asambleja e përgjithshme vodos me katër të pestat (4/5) e votave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.
- 11.2 Asambleja e përgjithshme vodos me tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalittë shoqërisë edhe për çështje te tjera si :
- përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - emërimin dhe shkarkimin e administratorit/ëve;
  - emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - përcaktimin e shpërblimeve
  - mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKB per te pasqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

#### Neni 12

##### Përjashtimi nga e drejta e votës

12.1 Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për:

- a) vlerësimin e veprimtarisë së tij;
- b) shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
- c) ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
- c) dhënien ose jo të përfitimeve të reja.

12.1 Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.



**Neni 13**  
**Administrimi**

13.1 Asambleja e përgjithshme emëron me 4/5 e votave të zotëruarëve të kapitalit të shoqërisë, një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.

13.2 Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

13.3 Administratorët e një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.

13.4 Personi me të dhënat si më poshtë vijon caktohet si Administrator i shoqërisë:

- **MARSEL MESITI** i datëlindjes 16/09/1990, i biri i XHELIL-it, lincur në Gramsh dhe banues në Rrugë "Besim Alla" Njesia Bashkiake Nr.14, Tirane, madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal J00916018D.

**Specimeni i nënshkrimit** 

**Neni 14**

**Kompetencat e Administratorit**

14.1 Administratori ka të drejtë dhe detyrohet të veprojë si më poshtë:

- a) të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësoj shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- c) përgatit dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqet këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme për miratim;
- d) krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryen regjistrimet dhe dërgojë të dhënrat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raporton përpara asamblesë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

ë) kryen detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.

14.2 Administratori është i detyruar të thërrasë Asamblenë e Përgjithshme, në rastet kur:

- sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim.
- shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
- shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

14.3 Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.

14.4 Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me  $\frac{3}{4}$  evotave të zotëruesve të kuotave të shoqërisë. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

14.5 Administratori ka të drejtë që në çdo kohë të japë dorëheqjen dhe në këtë moment mblidhet Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve të Shoqërisë për emërimin e administratorit të ri, i cili emërohet me  $\frac{3}{4}$  e votave të zotëruesve të kuotave të shoqërisë.

### Neni 15

#### Përgjegjesia e Administratorit

15.1 Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo për faje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.

15.2 Pasojat e marrëveshjeve të pamiratuara nga asambleja që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakeve /ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.

15.3 Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15, 17 e 18 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", administratori detyrohet:

- a) të kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe në statut në mirëbesim e në interesin më të mirë të shoqërisë në tërsi, duke i kushtuar vëmendje të veçantë ndikimit të veprimtarisë së shoqërisë në mëdësi;
- b) të ushtrojë kompetencat që i njihen në ligj dhe në statut vetëm për arritjen e qëllimeve të përcaktuara në këto dispozita;
- c) të vlerësojë me përgjegjësi çështjet, për të cilat merret vendim;
- ç) të parandalojë dhe mënjanjojë rastet e konfliktit, prezent apo të mundshëm, të interesave personalë me ata të shoqërisë;

- d) të ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
- 15.4 Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë për çdo veprim ose mosveprim, që lidhet në mënyrë të arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim të rasteve kur, në bazë të hetimit dhe vlerësimit të informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer në mirëbesim.
- 15.5 Nëse administratori vepron në kundërshtim me detyrat dhe shkel standardet profesionale, sipas pikave 1 e 2 të këtij neni, eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata, apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime të parregullta. Administratori ka barrën e provës për të vërtetuar kryerjen e detyrave të tij në mënyrë të rregullt e sipas standardeve të kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë në mënyrë solidare.
- 15.6 Në mënyrë të veçantë, por pa u kufizuar në to, administratori eshte i detyruar t'i dëmshpërblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, në kundërshtim me dispozitat e ligjit „Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare, kryen veprimet e mëposhtme:
- a) u kthen ortakëve kontributet;
  - b) u paguan ortakëve interesa apo dividendë;
  - c) u shpérndan aktivet shoqërisë;
  - ç) lejon që shoqëria të vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, në bazë të gjendjes financiare, duhej të parashikohej që shoqëria nuk do të kishte aftësi paguese për të shlyer detyrimet;
  - d) jep kredi.

#### KREU IV Viti finansiar-ekspertet

##### Neni 16

##### Viti Financiar

16. Viti finansiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare finansiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Biznesit dhe mbylltet me 31 Dhjetor.

##### Neni 17

##### Ekspertet

- 17.1 Eksperti ka per detyre qe të kontrolloje të gjithe dokumentacionin kontabel të veprimtarise ekonomiko tregtare të shoqerise, ate gjithëvjetor dhe ate ne lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij per rastet kur ai eshte ngarkuar dhe ka kryer një gje të tille i ngarkuar nga ana e ortakeve.
- 17.2 Ne perfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar pergatit raportin me shkrim per nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe per ate per kontrollet periodike të ushtruara, të cilat eshte i detyruar qe t'ja paraqese e dorezoje ne kohe ortakeve per t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazen e të drejtës vendimore qe ka.

**Kreu V**  
**Prishja –riorganizimi i shoqërisë**  
**Neni 18**

**Prishja dhe likuidimi**

- 18.1 Shperndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :
  - a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
  - b) me vendim të Asambiese se Ortakeve;
  - c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
  - ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
  - d) me vendim të gjykatës;
- 18.2 Ne kete rast Ortaket merrin vendim me shkrim ne të cilin parashikojne menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emertesen shtese " Shoqeri ne likuidim e siper".
- 18.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 18.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket me vendim asambleje
- 18.5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

**Neni 19**  
**Riorganizmi i shoqërisë bashkimi-ndarja**

- 19.1 Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas Vendimit të Mbledhjes së Përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në Pjesën IX të Ligjit 9901 datë 14.04.2012 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare."

**Neni 20**  
**Baza Ligjore**

- 20.1 Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
- 20.2 Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqipërisë.

**Neni 21**  
**Mosmarrëveshjet**

- 21.1 Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis Shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**Autorizohet Z.MARSEL MESITI** i datëlindjes 16/09/1990,i biri i XHELIL-it, lindur në Gramsh dhe banues në Rrugë “Besim Alla” Njesia Bashkiake Nr.14, Tirane , madhor e me zotësi të plotë juridike e për të vepruar, mbajtës i kartës së identitetit me nr. Personal J00916018D, që të kryejë dhe të nënshkruajë të gjitha dokumentet e nevojshme për regjistrimin e këtij statuti dhe regjistrimin e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**O R T A K Ě T**  
**E SHOQËRISE ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**  
**“LOG IN TAXI” SH.P.K.**

